



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 263, datë 21.11.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLAVE PLOTËSUERE TË VLERËSIMIT TË GJYQTARËVE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 pika 1 shkronja “a” të Kushtetutës, si dhe në nenet 2, 68-72, 74-78, 84-95, 97 dhe 171 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 25 të ligjit 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 96/2016”, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e “Skemës së vlerësimit të gjyqtarëve”.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**